



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas
Municipality



(Propozim)

**RREGULLORE PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË
KOMUNËN E DRAGASHIT**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (c) dhe nenit 40.2 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), dhe në mbështetje të Ligjit nr.2004/18 dhe Plotësim Ligjit nr.04/L-005 për Tregtinë e brendshme dhe Udhëzimit administrativ nr.2007/03, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizmit të tregtisë dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit, në seancën e mbajtur me datë _____, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË KOMUNËN E DRAGASHIT

I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- 1.1 Me këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të gjitha subjekteve afariste dhe shërbimeve tjera në territorin e komunës së Dragashit.
- 1.2 Subjektet afariste të regjistruara sipas dispozitave ligjore në fuqi janë të detyruara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuara me këtë rregullore.
- 1.3 Orari i fillimit dhe mbarimit të punës së përcaktuar me këtë rregullore si dhe pauza ditore, duhet të vendoset në hyrje të objektit në të cilin kryhet veprimtaria. Orari i punës para dite dhe pas dite si dhe ditët që nuk do të punohet duhet të saktësohet (caktohet) nga vetë pronari i objektit afarist, përveç rasteve kur është e caktuar ndryshe nga nenet e kësaj rregulloreje.

II

Përkufizimet

Neni 2

Fjalët dhe shprehjet të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si në vijim:

- 2.1 Lokal afarist-** Nënkupton objektin apo hapësirën punuese ku ushtrohet veprimtaria
- 2.2 "Person juridik"** nënkupton shoqërinë aksionare, partneritetet (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe komandite), kompaninë e huaj ndërmarrjen shoqërore dhe ndërmarrjen publike.
- 2.3 "Person fizik"** nënkupton individin dhe personin fizik si pronar i ndërmarrjes së regjistruar si biznes individual.
- 2.4 Inspektori-** personi zyrtar me autorizim dhe përgjegjësi të veçanta i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të subjekteve afariste
- 2.5 Periudha verore** nënkupton periudhën prej 01.05, zgjat deri me 30.09

- 2.6 Periudhe dimerore nënkupton periudhën prej 01.10 dhe zgjate deri me 30.04
- 2.7 Vikendi – nënkupton te premtën ne mbrëmje, te shtunën dhe te dielën
- 2.8 Festat zyrtare – dite feste sipas ligjit mbi festat zyrtare
- 2.9 Shitësi me shumicë është një ndërmjetës në zinxhirin shpërndarës që blen produktin në sasi të madhe nga prodhuesi dhe ia shet në masë më të vogël shpërndarësit apo shitësit me pakicë
- 2.10 Tregtia me pakicë nënkupton blerjen e mallit nga tregtari me shumicë, me qëllim të shitjes së tij tek konsumatori i fundit.

III

Orari i punës

Neni 3

Sipas kësaj rregullore përcaktohet orari i punës ne interval kohor dhe ate:

Periudha verore fillon me 01.05 dhe zgjate deri me 30.09

Periudha dimërore fillon me 01.10 dhe zgjate deri me 30.04

3.1 Veprimtaritë zeytare

3.1.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri me 20:00

3.1.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri me 19:00

3.1.3 Te dielave dhe ditëve te festave zyrtare nuk punojnë, përjashtim bëjnë sallonet e zbukurimit dhe kozmetikes

3.2 Furrat e bukës

3.2.1 Ne periudhën verore punojnë çdo dite pune prej orës 04:00 deri me 24:00

3.2.2 Ne periudhën dimërore punojnë çdo dite pune prej orës 04:00 deri me 22:00

3.3 Veprimtaritë tregtare me shumicë

3.3.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri me 20:00

3.3.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri me 18:00

3.3.3 Te dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë.

3.4 Veprimtaritë tregtare me pakice

3.4.1 Ne periudhe verore punojnë prej orës 07:00 deri ne orën 22:00

3.4.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri me 21:00

3.4.3 Te dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë.

3.5 Orari i punës se vetëshërbimeve, supermarketeve , dyqaneve tregtare

3.5.1 Ne periudhe verore punojnë prej orës 07:00 deri ne orën 22:00

3.5.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri me 21:00

3.5.3 Te dielave prej orës 08:00 deri me 16:00

3.6 Veprimtaritë hoteliere

3.6.1 Hotelet, Motelet, Bujtinat gjate gjithë vitit punojnë 24 ore,

3.6.2 Restorantet gjithë vitin punojnë prej orës 07:00 deri në 23:00

3.6.3 Kafiteritë, ëmbëltoret, byrektoret, qebaptoret, çajtoret, kioskat te cilat përgatitin ushqim te shpejtë, internet kafet punojnë sipas këtij orari:

3.6.3.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri me 24:00

3.6.3.2 Ne periudhën dimerore punojnë prej orës 07:00 deri me 23:00

3.6.4 Bastoret dhe lojrat tjera te fatit punojnë prej orës 08:00 deri ne ora 23:00

3.6.4.1 Bastoret sportive dhe lojërat e fatit të Hënën e kane dite pushimi (përkohësishtë në tërë territorin e Republikës së Kosovës janë të ndaluara) .

3.6.5 Disko klubet dhe klubet e natës punojnë prej orës 23:00 deri me 05:00, ose do te vetëpërcaktojnë orarin dhe për te njëjtin do te marrin pëlqim nga ana e Drejtorise përkatëse pranë K. K Dragash, si dhe do të njoftohet edhe inspektori i tregut.

3.6.6 Veprimtaritë e lartëpërmendura nga paragrafi 3.6.4 nuk lejohet qe gjate orarit te punës te prishin qetësin e qytetareve qe banojnë ne afërsi të tije qoftë me muzikë apo forma tjera nëse janë me afër se 100-500 metër nga objektet e banimit.

3.7 Veprimtarit shërbyese

3.7.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri ne orën deri ne orën 21:00

3.7.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri ne orën 19:00

3.7.3 Te dielave dhe festave nuk punojnë

3.7.4 Përshatim nga paragrafi 3.7.3 bejne autolarjet dhe autoparkingjet te cilëve u lejohet te punojnë edhe gjate te dielave.

3.8 Objektet për shitjen e karburanteve

3.8.1 Ne periudhën verore dhe dimërore punojnë 24 ore(non stop)

3.9 Barnatoret

3.9.1 Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri me 22:00

3.9.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 07:00 deri me 22:00

3.9.3 Se paku një barnatore do te kujdestarojë non-stop 24 orë

3.9.4 Orarin e kujdestarisë do ta pëcaktjnë subjektet afariste te cilat merren me këtë veprimtari se bashku me inspektorin e tregut.

3.9.5 Orari i kujdestarisë duhet te vendoset ne te gjitha barnatoret, ne shërbimin e emergjencës, ne QKMF dhe te gjitha QMF dhe te gjitha llojet e veprimtarive private mjeksore.

3.10 Veprimtarite private mjeksore, stomatologjike dhe te tjera

3.10.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri ne ora 22:00

3.10.2 Ne periudhën dimerore punojnë prej orës 08:00 deri ne ore 21:00

3.10.3 Perjashtim nga pikat 3.10.1 dhe 3.10.2 te këtij neni per raste emergjente te cilat per shkaqe te ndryshme nuk munde te trajtohen ne institucionet publike shendetesore.

3.11. Tregu i gjelbërt

3.11.1 Tregu i gjelbërt do te punoje te çdo ditë (Dragash) dhe te shtunën (Bresane)

3.11.2 Ne periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri ne ora 17:00

3.11.3 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 07:00 deri ne ora 15:00

3.11.4 Te dielave dhe festave nuk punon.

3.12 Tregu i kafshëve

3.12.1 Tregu i kafshëve do te punoje te Premten (Dragash)

3.12.2 Ne te dy periudhat kohore punon nga ora 07:00 deri ne ora 15:00

3.13 Veprimtaritë rekreative-sportive

3.13.1 Ne periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri ne orën 24:00

3.13.2 Ne periudhën dimërore punojnë prej orës 09:00 deri ne orën 23:00

3.13.3 Për objektet e mbuluara përgjatë gjithë vitit vlenë orari verore.

3.14 Veprimtaritë Ndërtimore përfshirë pllacet për shitje të materialeve ndërtimore dhe veprimtaritë të cilat shesin pajisje për rrymë, ujë dhe sanitari

3.14.1 Ne te dy periudhat punojnë prej 07:00 deri ne ora 18:00

3.14.2 Te dielave dhe festave nuk punojnë pllacet të cilat shesin material ndërtimorë dhe veprimtaritë të cilët shesin pajisje për rrymë, ujë dhe sanitari

3.14.3 Të premten nuk punojnë veprimtaritë ndërtimore (firmat të cilat merren me të gjitha llojet e ndërtimeve)

Neni 4

Subjektet afariste te cilat nuk janë te përfshira ne nenin 3 te kësaj Rregulloreje propozojnë orarin e punës te cilin ne forme te shkruar e përcakton dhe vërteton shërbimi i inspektoratit.

Neni 5

Subjektet afariste ne mënyrë të pavarur mundë të caktojnë një ditë pushimi gjate javës si dhe te deklarohen me shkrim për pauzën ditore.

Neni 6

Subjektet afariste gjate ushtrimit te veprimtarisë janë te detyruara t'u përmbahen dispozitave te Ligjit për rendin dhe qetësinë publike.

IV

Zgjatja e orarit të punës

Neni 7

7.1 Restorantet, kafe-baret, dyqanet hoteliere, vetëshërbimet, supermarketet, dyqanet tregtare, mundë të punojnë më gjatë se orari i përcaktuar i punës me këtë rregullore.

7.1 Për zgjatje të orarit të punës, duhet marrë Pëlqim nga Shërbimi i Inspektionit

7.2 Kërkesa për zgjatje të orarit të punës duhet ti parashtrohet shërbimit të inspektionit, inspektori i tregut do ti njoftojë subjektet afariste dhe Policinë e Kosovës brenda 8 ditë pune me nga një kopje të Pëlqimit mbi zgjatjen e orarit të punës

7.3 Kërkesës për zgjatje të orarit të punës subjektet afariste duhet ti bashkangjesin çertifikatën e biznesit si dhe fletëpagesën e taksës së përcaktuar me rregullore.

7.4 Për Pëlqimin e zgjatjes së orarit të punës subjektet afariste duhet të paguajnë:

7.4.1 Për periudhë verore _____ 50€

7.4.2 Për periudhë dimërore _____ 30€

Neni 8

Tërheqja e Pëlqimit të zgjatjes së orarit

8.1. Në rast të ankesave të banorëve dhe kërkesës nga organet e rendit, për prishje të rendit dhe qetësisë publike dhe vërtetimit nga shërbimi i inspektionit, subjekteve afariste mundë tu tërhiqet Pëlqimi për zgjatje të orarit të punës.

V

Vendosja e Simboleve Kombëtare gjatë festave

Neni 9

9.1 Të gjitha llojet e veprimtarive private dhe publike të cilat operojnë në Komunën e Dragashit, ditëve të festave kombëtare dhe shtetërore, të përcaktuara sipas Ligjit mbi festat zyrtare, janë të obliguara të vendosin në vend të dukshëm flamurin Shtetërorë të Republikës së Kosovës

9.2 Flamuri duhet të jetë i vendosur në mënyrë të duhur

9.3 Mbikqyrjen e këtij neni e bënë Inspektori Komunal

VI

Dispozitat ndëshkuese

Neni 10

10.1 Shkeljet e kësaj rregulloreje përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si në vijim:

10.1.1 Subjektet afariste të cilat nuk i përmbahen nenit 1 paragraf 1.2 dhe 1.3 të Kësaj Rregulloreje dënohen me gjobë administrative 150€-250 € ,

10.1.2 Të gjitha subjektet afariste të cilat do të konstatohet se e kanë zgjatur orarin e punës pa pëlqim do të dënohen me gjobë administrative 150€-300€

10.1.2 Të gjitha veprimtaritë të cilat nuk i përmbahen nenit 9 paragrafëve 9.1 dhe 9.2 dënohen me gjobë administrative 100€-200€

10.1.3 Mosëvendosja e orarit të kujdestarisë sipas nenit 3 paragrafi 3.9.5 dënohet me gjobë administrative 100€-200€

10.2 Në raste se subjekti nuk bënë ekzekutimin e gjobës dhe nuk sjellë dëshmi mbi pagesën e sajë brenda afatit të dhënë me Aktvendim nga inspektorët kompetent, inspektori mundë të iniciojë procedurë për Kundërvajtje në Gjykatën kompetente brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur Aktvendimi bëhet i plotfuqishëm.

10.3 Inspektori ka të drejtë të iniciojë edhe procedura tjera administrative për ekzekutimin e gjobës, kur kjo është e rregulluar me ligj të veçantë.

10.4 Mjetet e mbledhura derdhen në Buxhetin Komunal.

VII

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 11

11.1 Nëse inspektori gjatë inspektimit konstaton se subjekti afarist nuk e respekton orarin e punës të përcaktuar me këtë rregullore, me procesverbal i ndalon ushtrimin e veprimtarisë dhe inicion procedurat e ndëshkimit sic është paraparë me këtë Rregullore

11.2 Ankesa në Aktvendim nuk e ndalon ekzekutimin e Aktvendimit.

11.3 Të gjitha veprimtaritë afariste janë të obliguara të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje

11.4 Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset shërbimi i Inspektionit në bashkëpunim me Policinë, sipas nevojës.

Neni 12

Dispozita shfuqizuese

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja 01Nr.06-44 "Mbi caktimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Dragashit.

Neni 13

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës.

01 Nr. _____
Dt. _____ 2019

D r a g a s h

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH

Kryesuesi

Betim Merdiu